



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 221

Tiranë – E Martë, 21 Prill 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr. 11, datë 2.7.2014	Për vendndodhjen dhe kushtet e tjera të tregjeve të shitjes me shumicë..... 12959

**UDHËZIM****Nr. 11, datë 2.7.2014****PËR VENDNDODHJEN DHE KUSHTET
E TJERA TË TREGJEVE TË SHITJES ME
SHUMICË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, me propozim të Drejtorisë së Prodhimit Bujqësor dhe Politikave Tregtare, Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

UDHËZON:

1. Tregjet e produkteve agro-ushqimore me shumicë duhet të plotësojnë këto kritere:

a) Të jenë jashtë vijës së verdhë të qyteteve në një distancë jo më të afërt se 500 m nga vija e verdhë;

b) Me një distancë jo më pak se 500 m nga zona të miratuara për banim ose pushim;

c) Brenda zonave të miratuara për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të produkteve agro-ushqimore me shumicë, të përcaktuara në këtë udhëzim;

d) Pranë rrugëve kryesore dhe lehtësisht i aksesueshëm;

e) Jo më pak se 1 kilometër larg zonave të kontaminuara ose me ndotje mjedisore, si fabrika që prodhojnë ose gjenerojnë mbetje të dëmshme për shëndetin, mbetje kimike etj.;

f) Duhet të kenë 2 porta, një hyrëse dhe një dalje;

g) Numri i magazinave brenda stabilimentit të jetë jo më pak se 10 (dhjetë);

h) Të ketë ambiente frigoriferike;

i) Të ketë ambiente të veçanta për punonjësit;

j) Objekti të jetë i rrethuar; të jetë i pajisur 24 orë me ujë dhe energji elektrike.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Prodhimit Bujqësor dhe Politikave Tregtare dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT
TË UJËRAVE
Edmond Panariti**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 28 lekë